



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

NJOFTIM

PËR RISHPALLJEN E KËRKESËS PËR KANDIDATURA NGA RADHËT E GJYQTARËVE, PËR KOMANDIM NË MINISTRINË E DREJTËSISË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 250, datë 09.07.2020, ka vendosur :

- *Rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë për:*
 - a) *Pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit;*
 - b) *Pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.*

Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:

Çdo gjyqtar të interesuar, që plotëson kushtet dhe kriteret e komandimit, për të paraqitur kërkesë për komandim ku të specifikohet pozicioni ku kërkon të komandohet.

Kohëzgjatja e komandimit, në secilin nga dy pozicionet e shpallura, është deri në 5 (pesë) vjet.

Kohëzgjatja e komandimit mund të përfundojë para afatit:

- a) me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;
- b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit.

Kushtet e komandimit, në secilin nga dy pozicionet e shpallura, janë:

- a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

- b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
- c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;
- ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë, duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
- d) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.

Kriteret e komandimit për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, janë:

- a) kandidati duhet të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
- b) kandidati duhet të ketë ushtruar profesionin e gjyqtarit për të paktën 5 vjet, duke u vlerësuar pozitivisht pasja përvojë në hartim aktesh, si dhe në pozicione drejtuese;
- c) kandidati duhet të zotërojë një gjuhë të huaj, preferohet anglisht;
- ç) kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- d) kandidati duhet të ketë aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi, si dhe për të punuar në grup;
- dh) kandidati duhet të ketë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit.

Kriteret e komandimit për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, janë:

- a) kandidati duhet të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
- b) kandidati duhet të ketë ushtruar profesionin e gjyqtarit për të paktën 3 (tre) vjet, duke u vlerësuar pozitivisht pasja përvojë në hartim aktesh, si dhe në pozicione drejtuese;
- c) kandidati duhet të zotërojë një gjuhë të huaj, preferohet anglisht;
- ç) kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- d) kandidati duhet të ketë aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi, si dhe për të punuar në grup;
- dh) kandidati duhet të ketë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit.

Plotësimi i kushteve të komandimit do të verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimin e sipërcituar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

- a) Kërkesë me shkrim për shfaqjen e vullnetit për komandim ku të specifikohet pozicioni ku kërkon të komandohet;
- b) Jetëshkrim, ku kandidati pasqyron, veç të tjerash, çdo të dhënë në lidhje me kriteret e komandimit, përveç edhe të dhënat mbi historikun e arsimimit dhe rezultatet e tij;
- c) Diplomë për fitimin e titulli magjistrat, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës;

- ç) Dokument që vërteton përvojën në hartimin e akteve;
- d) Certifikatë/Dëshmi për zotërim gjuhe të huaj;
- e) Rekomandime për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup;
- ë) Certifikatë/Dëshmi për njohjen dhe përdorimin e programeve kompjuterike bazë;
- f) Çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

Dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet nga kandidati pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën Bulevardi “Zog I”, Tiranë.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin shoqërues është dy javë nga dita e publikimit të këtij njoftimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. - Ky afat përfundon më datë 24.07.2020.

Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me kohëzgjatjen, kushtet, kriteret dhe procedurat e komandimit, mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me Vendimin nr. 250, datë 09.07.2020, “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit”.

Ky njoftim është publikuar më datë 10.07.2020.